



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 60, datë 18. 08. 2004

PËR MIRATIMIN E

**“RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE
PËR MUAJIN KORRIK TË VITIT 2004”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Raportin e Politikës Monetare për muajin korrik të vitit 2004”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij raporti në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Shkëlqim Cani

PËRMBAJTJA

I.	Zhvillimet kryesore të muajit	2
II.	Ecuria e inflacionit në muajin korrik 2004.....	4
II.1	Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse.....	4
II.2	Situata makroekonomike dhe çmimet e konsumit.	7
III.	Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare.....	9
III.1	Politika monetare e Bankës së Shqipërisë.....	9
III.2	Ecuria e agregatëve monetarë	10
III.3	Kërkesa e ekonomisë për para	13
III.3.1	Mjetet valutore neto	13
III.3.2	Kërkesa e qeverisë për para.....	13
III.3.3	Kredia për ekonominë nga sistemi bankar.....	14
IV.	Tregjet dhe ecuria e normave të interesit	17
IV.1	Ecuria e likuiditetit.....	17
IV.2	Ecuria e normave të interesit.....	18
IV.3	Kursi i këmbimit.....	20

I. ZHVILLIMET KRYESORE TË MUAJIT

- Inflacioni mujor në muajin korrik shënoi vlerën - 0.15 për qind duke e cuar inflacionin vjetor në 3.1 për qind. Kjo normë, si dhe inflacioni vjetor mesatar prej 3.22 për qind, rezultuan brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.
- Muaji korrik 2004 ka respektuar tendencën historike të normave mujore negative të inflacionit. Zhvillimet e regjistruara në çmimet e konsumit për këtë muaj kanë qenë brenda parametrave normalë.
- Edhe gjatë muajit korrik, faktorët e kërkesës nuk kanë ushtruar presion në rritje të normës së inflacionit. Zbehja e efektit sezonal të hyrjes së prodhimit të brendshëm shkaktoi rritjen e shifrës së inflacionit vjetor për muajin korrik. Gjithsesi, presionet inflacioniste mbeten të kontrolluara dhe inflacioni vazhdon të qëndrojë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.
- Zhvillimet në çmimet e konsumit dhe gjendja e stabilizuar e treguesve monetarë i kanë mundësuar Bankës së Shqipërisë ndjekjen e një politike më të zbutur monetare. Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit në datat 23 qershor dhe 28 korrik. Norma bazë e interesit u ul me 0.25 pikë përqindjeje në të dy rastet, duke arritur në nivelin 5.5 për qind.
- Reagimi ndaj politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë është vënë re në tregun e depozitave në lekë, në tregun primar dhe në tregun ndërbankar. Reduktimi më i ndjeshëm i normës së interesit ka ndodhur për depozitat njëmujore dhe tremujore.
- Norma e rritjes vjetore të ofertës monetare shënoi një ulje të lehtë në muajin qershor, si pasojë e kërkesës së ulët të qeverisë dhe mbiçmimit të lekut në këtë muaj. Me uljen e normave të interesit dhe ruajtjen e inflacionit afër mesatares së intervalit objektiv, norma reale e interesit ka pësuar rënie, duke u shoqëruar me zbutjen graduale të tendencës rënëse të raportit të parasë jashtë bankave ndaj M3.
- Teprica e kredisë gjatë muajit qershor të vitit 2004 shënoi një rritje mujore prej 0.6 miliardë lekësh. Krahasuar me fundin e vitit 2003 ajo është rritur me 6.1 miliardë lekë. Kreditimi i ekonomisë nga sistemi bankar në nivel mesatar mujor rezulton pranë parashikimeve të programit monetar për vitin 2004.

- Tendenca e mëparshme e mbiçmimit të lekut ka vijuar të ndihet edhe gjatë muajit korrik. Rritja e prurjeve të valutës në sezonin turistik dhe rritja e prodhimeve bujqësore të vendit, kanë ndikuar në ruajtjen e tendencave mbiçmuese të lekut.

II. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN KORRIK 2004.

II.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE.


Inflacioni vjetor në muajin korrik shënoi një vlerë prej 3.1 për qind. Kjo normë, si dhe inflacioni vjetor mesatar prej 3.22 për qind, rezultuan brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Efekti sezonal rënës i hyrjes së prodhimit të brendshëm bujqësor dha një ndikim të zbutur në inflacionin e muajit korrik, duke reflektuar futjen më të hershme në treg të tij gjatë vitit 2004. Ky faktor, shoqëruar edhe me përqëndrimin e aktivitetit turistik dhe rritjen e kërkesës në muajt korrik-gusht, ndikuan në një rritje të lehtë të normës mujore të inflacionit në krahasim me muajt maj - qershor.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).


	2000	2001	2002	2003	2004
Janar	-1.3	2.2	6.5	0.0	3.3
Shkurt	-1.3	1.5	7.6	1.1	4.4
Mars	-2.1	2.9	7.5	1.3	4.0
Prill	-1.4	3.0	6.5	2.3	3.2
Maj	-0.1	2.5	4.6	2.8	2.6
Qershor	0.1	4.0	3.7	2.6	2.9
Korrik	-1.3	5.6	4.2	3.0	3.1
Gusht	-0.7	4.1	5.5	3.0	
Shtator	0.9	3.5	5.3	2.8	
Tetor	1.8	1.8	5.8	2.9	
Nëntor	1.9	2.8	3.7	3.4	
Dhjetor	4.2	3.5	1.7	3.3	
Mesatar	0.05	3.13	5.22	2.37	

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në për qind).



Megjithë ndikimin që ka dhënë ecuria e çmimeve të produkteve bujqësore në sjelljen e normës mujore të inflacionit në muajin korrik, ndikimin kryesor në ecurinë e normës vjetore të inflacionit edhe këtë muaj vazhdon ta japë grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” në inflacionin vjetor në muajin korrik ishte 2.4 pikë përqindjeje. Norma prej 9.9 për qind e inflacionit vjetor të këtij grupi rezultoi nga rritja me 5.3 pikë përqindjeje e inflacionit të nëngrupit “Furnizim me ujë” në muajin korrik.

Tabelë 2. Norma mujore dhe vjetore e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”.

	Grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”		Nëngrupi “Qira”		Nëngrupi “Lëndë djegëse dhe energji”	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Korrik '04	0.1	9.9	0.0	5.6	-0.1	26.9
Korrik '03	0.0	0.4	0.0	-1.7	-0.1	6.7


Grupi “Ushqime dhe pije joalkolike”, ashtu si edhe gjatë muajve të shkuar, ka dhënë një ndikim jo shumë të ndjeshëm në inflacionin vjetor të muajit korrik (shih grafikun 2). Kontributi i këtij grupi në inflacionin vjetor të muajit korrik ishte negativ, -0.05 pikë përqindjeje. Norma mujore e inflacionit të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” prej -0.4 për qind tregoi për veprimin më të dobët të efektit rënës sezonal që vjen nga plotësimi i kërkesës në vend nga oferta e brendshme. Prodhimi bujqësor më i bollshëm gjatë këtij viti, i ndikuar edhe nga rritja e prodhimit të serave, filloi ndikimin e tij rënës që në muajin prill 2004. Si pasojë e përmirësimeve teknologjike, e rritjes së sipërfaqeve të serave dhe rritjes së prodhimit bujqësor vendas, efekti i këtij faktori po vjen duke u afruar në kohë gjatë viteve të fundit. Kështu, për vitin 2004, efekti sezonal rënës është vënë re që në muajin maj.

Tabelë 3. Norma mujore dhe vjetore e grupit “Ushqim dhe pije alkolike”.

	“Ushqim dhe pije joalkolike”		Nëngrupi “Fruta”		Nëngrupi “Zarzavate”	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Korrik '04	-0.4	-0.1	3.7	10.9	-5.9	-15.4
Korrik '03	-1.0	6.2	-2.2	19.2	-3.9	30.1


Edhe grupi “Transport” shënoi rritje të normës vjetore të inflacionit gjatë muajit korrik. Norma vjetore e inflacionit të këtij grupi arriti në 2.8 për qind kundrejt 2.5 për qind në muajin qershor

Grafik 3. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Megjithë zhvillimet e mësipërme, muaji korrik 2004 ka respektuar tendencën historike të normave mujore negative të inflacionit. Zhvillimet e regjistruara në çmimet e konsumit për këtë muaj kanë qenë brenda parametrave normalë.

Grafik 4. Ecuria e normës mujore të inflacionit në muajt korrik.




II.2 SITUATA MAKROEKONOMIKE DHE ÇMIMET E KONSUMIT.

Faktorët e kërkesës nuk kanë shënuar zhvillime të veçanta gjatë muajit korrik, ndërkohë që politika monetare dhe ajo fiskale kanë vijuar të japin një ndikim pozitiv në zhvillimet e inflacionit.

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare zbutëse gjatë vitit 2003 dhe në vazhdim të vitit 2004. Megjithatë, situata e likuiditetit ka qenë e qëndrueshme, agregatët monetarë kanë lëvizur brenda parashikimeve ndërkohë që financimi i brendshëm i deficitit buxhetor është ruajtur brenda kufirit të lejuar. Normat e ndryshimit vjetor të agregatëve monetarë M1 dhe M3 paraqiten afër vlerave mesatare historike.

Grafik 5. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në për qind).



Mbiçmimi i lekut gjatë vitit 2004, i shoqëruar nga norma të qëndrueshme të inflacionit të regjistruara në vendet partnere të shkëmbimeve, kanë zbutur efektin që jep inflacioni i importuar në inflacionin në vend.


Tabelë 4. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në për qind).

	Dhjetor'03	Janar'04	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Greqi	3.1	3.1	2.6	2.9	3.1	3.1	3.0
Itali	2.5	2.2	2.4	2.3	2.3	2.3	2.4

Burimi: Eurostat News Release.

Në kontrollin e kërkesës ka ndikuar edhe ruajtja e shpenzimeve buxhetore brenda kufijve të planifikuar, duke kontrolluar presionet inflacioniste që mund të shkaktohen nga ky faktor.

Grafik 6. Ecuria e shpenzimeve vjetore buxhetore (në përqindje ndaj PBB-së).



Të gjitha këto kanë krijuar një ambient të përshtatshëm monetar për kontrollin e inflacionit. Efekti negativ që dhanë në inflacion disa faktorë të ofertës si rritja e çmimeve të administruara apo rritja e kërkesës së brendshme, si pasojë e fillimit të sezonit turistik, u balancuan deri-diku nga hyrja e prodhimit vendas për muajt maj - qershor.

Edhe gjatë muajit korrik, faktorët e kërkesës nuk kanë ushtruar presion në rritje të normës së inflacionit. Zbehja e efektit sezonal të hyrjes së prodhimit të brendshëm, shkaktoi rritjen e shifrës së inflacionit vjetor për muajin korrik. Megjithatë, presionet inflacioniste mbetën të kontrolluara dhe inflacioni ishte brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rritjen e çmimit të naftës në tregun botëror që rifilloi në fillim të muajit gusht, gjykon se rreziku ndaj çmimit të naftës në inflacion është më serioz sesa krahasuar me rritjen e ndërmarrë në këtë treg gjatë fundit të pranverës. Kjo sepse:

- Gjatë stinës së vjeshtës, vihet re një shtim i importeve duke sjellë rritje të presioneve inflacioniste që vijnë nga vendet kryesore partnere, në të cilat mund të ndjehet efekti i rritjes së çmimit të naftës. Ky shqetësim është shprehur kohët e fundit edhe nga Banka Qëndrore Evropiane.
- Çmimi i lartë i naftës në nivele 90-95 lekë për litër përcjell presione të forta në çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të lidhura drejtpërdrejt me të. Ky efekt përforcohet edhe për faktin se shumica e prodhimeve të stinës së vjeshtës vijnë nga serat duke rritur ndjeshëm kërkesën për naftë. Një faktor që pritet të shtojë kërkesën është fakti se prej vitesh nafta shërben si zëvendësues i energjisë elektrike, e cila megjithë situatën e përmirësuar të furnizimit vazhdon të vuajë perioda ndërprerjesh si ato të fundvitit.


Gjatë 2-3 muajve të ardhshëm Banka e Shqipërisë do të vazhdojë ta vlerësojë nga afër efektin dhe intensitetin që do të japë rritja e mëtejshme e çmimeve të naftës në ecurinë e normës së inflacionit dhe rritjen ekonomike.

III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

III.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË


Zhvillimet në çmimet e konsumit dhe gjendja e stabilizuar e treguesve monetarë kanë bërë të mundur ndjekjen e një politike më të zbutur monetare nga Banka e Shqipërisë. Kështu, parashikimet flasin për respektimin e objektivit të inflacionit ndërkohë që ecuria e treguesve monetarë paraqitet e kontrolluar. Niveli i likuiditetit paraqitet nën trendin historik (shih grafikun 7) ndërsa kursi i këmbimit ka patur tendenca mbiçmuese.

Grafik 7. Ecuria e rritjes vjetore reale të agregatit monetar M1.



Duke u bazuar në politikën e saj të deklaruar, për të ruajtur në ekonomi kushtet më të lehta monetare të cilat janë në përputhje me respektimin e objektivit të inflacionit, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit në datat 23 qershor dhe 28 korrik. Norma bazë e interesit u ul me 0.25 pikë përqindjeje në të dy rastet, duke arritur në nivelin 5.5 për qind.

Grafik 8. Ecuria e normës bazë të interesit.



Banka e Shqipërisë ka financuar gjatë muajit qershor deficitin buxhetor të qeverisë me 3.4 miliardë lekë në formën e kredisë direkte. Kjo lëvizje ka synuar të ushtrojë presion mbi bankat për të përcjellë uljen e normave të interesit edhe në tregun e bonove të thesarit.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të tërheqë likuiditetin e tepërt të sistemit bankar me anë të përdorimit të instrumentit të marrëveshjeve të riblerjes, duke përdorur të dy llojet e ankandëve. Gjatë muajit korrik, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme dhe në tregun valutor duke synuar kontrollin e presioneve sezonale mbiçmuese mbi lekun. Këto tërheqje kanë çuar në hedhjen në treg të 1.06 miliardë lekëve.

Banka e Shqipërisë ka respektuar objektivat e saj sasiorë gjatë muajve qershor-korrik.

Tabelë 5. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.


	Dhjetor '03	Mars 04	Maj 04	Qershor 04	Korrik 04*
Rezerva ndërkombëtare neto (në milionë dollarë)					
Objektivi	715.8	751.8	761.2	765.8	818.4
Aktuale	832.7	827.6	962.1	961.5	942.9
Diferenca	116.8	75.8	201.0	195.7	124.4
Mjetet e brendshme neto (në miliardë lekë)					
Objektivi	96.0	83.0	84.3	85.0	80.0
Aktuale	72.0	66.4	51.3	54.7	61.6
Diferenca	-24.0	-16.6	-33.0	-30.3	-18.4
Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)					
Objektivi	280.9	272.8	270.1	268.8	284.5
Aktuale	266.8	272.6	260.3	262.1	--
Diferenca	0.0	-0.2	-9.9	-6.7	--

* Të dhënat për muajin korrik janë operative.

III.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Ecuria e treguesve monetarë gjatë muajit qershor ka qenë në përputhje me tendencat e vërejtura gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Norma e rritjes vjetore të ofertës monetare shënoi një ulje të lehtë në muajin qershor, si pasojë e kërkesës së ulët të qeverisë dhe e mbiçmimit të lekut në këtë muaj.


Grafik 9. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.



Pas një periudhe të gjatë rënieje, raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 ka shfaqur shenja stabilizimi gjatë muajve të fundit. Në muajin qershor ky raport është rritur me 0.3 pikë përqindjeje, duke shënuar vlerën 25.8 për qind. Gjithsesi, ai mbetet afër minimumit historik prej 25.5 për qind, të shënuar në muajin maj. Kthimi i parasë në sistemin bankar dhe rritja e depozitave bankare në kushtet e një periudhe të lehtësimit të kushteve monetare është rezultat i rritjes së besimit të publikut në sistemin bankar. Me uljen e normave të interesit dhe ruajtjen e inflacionit afër mesatares së intervalit objektiv, norma reale e interesit ka pësuar rënie, duke u shoqëruar me zbutjen graduale të tendencës rënëse të raportit të parasë jashtë bankave ndaj M3.

Gjithashtu, bazuar në ecurinë historike të viteve të fundit të rritjes së shpenzimeve konsumatore gjatë muajve të verës, Banka e Shqipërisë parashikon rritje të nivelit të parasë jashtë bankave si edhe të raportit të këtij treguesi ndaj M3. Megjithatë, ky raport do të ngelet brenda parashikimeve të programit të Bankës së Shqipërisë, duke mos çënuar ecurinë e treguesve të tjerë monetarë dhe të objektivit të inflacionit.

Grafik 10. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real.



Ritmi vjetor i rritjes së depozitave në lekë, në muajin qershor, rezultoi 9.5 për qind. Në terma mujorë niveli i depozitave në lekë ka pësuar një rënie të lehtë prej 0.6 miliardë lekësh (0.2 për qind), ndërkohë që paraja jashtë bankave është rritur vetëm 0.9 për qind ose 1.1 miliardë lekë. Ritmet e ngadalta të

ndryshimeve mujore të këtyre dy treguesve, parasë jashtë bankave dhe depozitave në lekë, në muajt e fundit nuk kanë mbështetur rritjen e agregatit M2. Ritmi i rritjes vjetore të M2 në muajin qershor rezultoi 5.9 për qind, duke qëndruar në linjë me tendencën rënëse të këtij treguesi të shfaqur gjatë tre muajve të fundit. Kjo ecuri e agregatit M2 ka reflektuar përgjithësisht kërkesën e dobët të qeverisë dhe të sektorit privat të ekonomisë për mjete monetare të brendshme.

Rritja e depozitave në valutë në terma vjetorë është në përputhje me trendin historik, duke shënuar 12.6 për qind. Rënia e tyre me 2.6 miliardë lekë gjatë muajit qershor ose 2.4 për qind në terma mujorë, është rezultat i mbiçmimit të lekut ndaj usd dhe euro, duke ulur kështu vlerën e depozitave në valutë të shprehura në lekë. Në mungesë të ndryshimit të kursit të këmbimit të lekut ndaj dy monedhave kryesore gjatë muajit qershor, niveli i depozitave në valutë do të ishte 3.4 miliardë lekë ose 3.2 për qind, më i lartë.

Tabelë 6. Ecuria e treguesve monetarë në muajin qershor (në miliardë lekë).

	Qershor	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2004	absolut	përqindje	absolut	përqindje
Para jashtë bankave	118.2	1.1	0.9	-0.6	-0.5
Depozita totale	339.9	-3.2	-0.9	32.2	10.4
- në lekë	235.5	-0.6	-0.2	20.5	9.5
- në valutë	104.5	-2.6	-2.4	11.7	12.6
Depozita pa afat	65.0	-1.7	-2.6	9.9	17.9
- në lekë	22.3	-0.2	-0.9	2.4	12.2
- në valutë	42.6	-1.5	-3.4	7.4	21.1
Depozita me afat	275.0	-1.5	-0.5	22.3	8.8
- në lekë	213.1	-0.4	-0.2	18.0	9.3
- në valutë	61.8	-1.1	-1.7	4.2	7.4
M1	140.6	0.9	0.6	1.8	1.3
M2	353.7	0.5	0.2	19.8	5.9
M3	458.2	-2.1	-0.5	31.5	7.4
Baza monetare	157.0	3.3	2.2	5.3	3.5


III.3 KËRKESA E EKONOMISË PËR PARA

III.3.1 MJETET VALUTORE NETO

Mjetet valutore neto të sistemit bankar në muajin qershor kanë pësuar një rënie prej 22.9 milionë usd. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së mjeteve valutore të bankave të nivelit të dytë, ndërkohë që edhe mjetet valutore të Bankës së Shqipërisë kanë patur një efekt negativ, duke shënuar ulje me 2.3 milionë usd. Nënçmimi me rreth 0.75 për qind i euros ndaj dollarit në muajin qershor ka bërë që rezerva valutore e investuar në euro të ndikohet negativisht me 4.2 milionë usd. Në mungesë të këtij efekti rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë do të rezultonte 1.9 milionë usd më e lartë.

Mjetet valutore neto të bankave tregtare kanë shënuar një rënie të nivelit të tyre me 20.6 milionë usd. Rritja më e madhe e kredisë në valutë se sa rritja e depozitave në valutë kanë qenë përcaktuesit kryesor të kësaj ecurie.


Grafik 11. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.



III.3.2 KËRKESA E QEVERISË PËR PARA

Deficiti buxhetor arriti në 7.1 miliardë në fund të muajit qershor. Deficiti buxhetor ka filluar të thellohet që nga muaji prill e në vazhdim. Vetëm për muajin qershor ai është rritur me rreth 2 miliardë lekë. Financimi gjithsej për periudhën janar- qershor arriti vlerën 9.4 miliardë lekë dhe është pothuajse financim i brendshëm dhe nga sistemi bankar.

Grafik 12. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



Ndryshe nga muajt e mëparshëm të vitit, forma kryesore e financimit gjatë muajit qershor ka qenë kredia direkte e akorduar nga Banka e Shqipërisë prej 3.4 miliardë lekësh. Gjithashtu, qeveria ka përdorur edhe obligacionet 2-vjeçare të emetuara në tregun primar, në masën 0.8 miliardë lekë si dhe të ardhurat e privatizimit. Portofoli i bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë është reduktuar me rreth 3.8 miliardë lekë, ndërsa portofoli i individëve dhe institucioneve financiare ka pësuar gjatë muajit një rritje të lehtë me përkatësisht 0.5 dhe 0.4 miliardë lekë. Reduktimi i theksuar i portofolit të bankave tregtare erdhi si rezultat i refuzimit nga ana e qeverisë për të pranuar kërkesën e disa bankave për të investuar fondet e tyre me një *yield* më të lartë se ai i tregut.

Sipas të dhënave operative të muajit korrik, vihet re një thellim i deficitit buxhetor gjatë muajit korrik me rreth 4.1 miliardë lekë. Ky thellim ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve buxhetore gjatë muajit korrik si dhe i realizimit dhe thithjes së të ardhurave në nivele më të ulëta se sa ato të planifikuara, fakt që lidhet edhe me natyrën sezonale të ecurisë së treguesit të të ardhurave. Forma kryesore e financimit të deficitit për muajin korrik, ka qenë jo vetëm burimet e thithura nga tregu primar por edhe arkëtimi prej rreth 3.5 miliardë lekësh i të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve.

III.3.3 KREDIA PËR EKONOMINË NGA SISTEMI BANKAR.

Teprica e kredisë gjatë muajit qershor të vitit 2004 shënoi një rritje mujore prej 0.6 miliardë lekësh. Krahasuar me fundin e vitit 2003 ajo është rritur me 6.1 miliardë lekë. Kreditimi i ekonomisë nga sistemi bankar në nivel mesatar mujor rezulton pranë parashikimeve të programit monetar për vitin 2004, rreth 1.0 miliardë lekë. Mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut kundrejt usd dhe euros ka ndikuar në drejtim të uljes së vlerës në lekë të tepricës së kredisë në valutë. Forcimi i lekut ndaj usd dhe euros, respektivisht me 4.8 për qind

dhe 8 për qind për periudhën dhjetor '03-qershor '04, ka ndikuar në uljen e tepricës së kredisë gjithsej me rreth 3.4 miliardë lekë. Duke mënjanuar këtë efekt, teprica e kredisë është rritur me 9.5 miliardë lekë për këtë periudhë.

Rritja e tepricës së kredisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit përbën 37 për qind të nivelit të parashikuar të rritjes vjetore në programin monetar. Ky tregues ka qenë në një nivel mesatar prej 41 për qind gjatë tre viteve të shkuara. Duke u nisur nga ky fakt, si dhe nga aktivizimi i pritur i Bankës së Kursimeve në tregun e kredisë, mendojmë se parashikimi i programit monetar për rritjen vjetore të kredisë në masën 16.5 miliardë lekë, do të realizohet.

Struktura e tepricës së kredisë sipas afateve vazhdoi të pësojë ndryshime në drejtim të rritjes së kredisë afatmesme dhe afatgjatë edhe gjatë muajit qershor. Sistemi bankar ka qenë më i orientuar nga investimet afatmesme dhe afatgjata të fondeve të tij gjatë vitit 2004, duke kontribuar më shumë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kështu, në fund të muajit qershor teprica e kredisë afatmesme dhe afatgjatë përbënte 64.6 për qind të tepricës së kredisë, nga 61.5 për qind në fund të majit maj dhe 54 për qind në fund të vitit 2003. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë. Ndërkohë, vërehet një rritje e preferencës në marrjen e kredisë në monedhën evropiane. Struktura e tepricës së kredisë në valutë ndryshoi në 48 për qind në usd dhe 52 për qind në euro në fund të muajit qershor 2004, nga 50 me 50 që ishte në fund të vitit 2003.

Tabelë 7. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë (në përqindje).

	2002	2003	T1 '04	Maj '04	Qer. '04
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	38.5	35.4
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	37.1	37.8
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	24.4	26.8
Spektori privat ¹	99.8	100.0	100.0	100	100
Spektori shtetëror	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
Lekë	21.3	19.6	17	17	17
Valutë	73.7	80.4	83	83	83
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	56.2	56.8

Kredia e re e lëvruar gjatë muajit qershor të vitit 2004 është 7.6 miliardë lekë. Ndërkohë, për periudhën janar-qershor 2004 janë akorduar 56.4 miliardë lekë

¹ Në këtë klasifikim, 99 për qind i takon sektorit privat dhe individëve dhe 1 për qind institucioneve financiare.

kredi ose 34 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kredia afatshkurtër ka përbërë 65 për qind të totalit të kredisë së re të akorduar. Nga këndvështrimi valutor, kredia e re e akorduar në lekë përbën 31 për qind të totalit të kredisë.

Tabelë 8. Ecuria e kredisë së re në vite (në miliardë lekë).

	2002	2003	T1 '04	Maj '04	Qer. '04
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	18.7	6.5	4.6
Kredi afatmesme	13.0	22.2	5.7	2.5	2.0
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	3.5	1.2	1.0
Sektori shtetëror	0.06	0.04	0.0	0.0	0.0
Sektori privat	62.5	92.6	27.9	10.2	7.6
Lekë	20.8	30.8	8.80	3.9	2.6
Valutë	41.8	61.8	19.10	6.3	5.0
Kredi e re (në mld lekë)	62.6	92.6	27.9	10.2	7.6

Degët më të kredituara nga sistemi bankar në fund të muajit qershor vazhdojnë të jenë tregtia, industria përpunuese, pasuritë e patundshme dhe ndërtimi. Veçojmë se vërehet një tendencë rënëse e financimeve nga ana e bankave për aktivitete tregtare gjatë pjesës së parë të vitit 2004, duke u orientuar në degë të tilla si industri përpunuese, bujqësi, hotele, restorante etj..

Tabelë 9. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).

	2002	2003	T-1 '04	Maj '04	Qer. '04
1 Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	1	1.0	1.1	1.2
2 Peshkimi	0.2	0	0.1	0.1	0.1
3 Industria nxjerrëse	0.2	1	0.2	0.2	0.2
4 Industria përpunuese	17.0	17	16.9	18.0	18.4
5 Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë	3.3	3	3.0	3.2	3.3
6 Ndërtimi	8.6	10	9.7	10.8	10.7
7 Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	31.4	25.3	23.5
8 Hotele dhe restorante	6.0	6	7.1	7.8	8.3
9 Transporti dhe telekomunikacioni	2.4	1	2.0	1.3	1.5
10 Aktivitete financiare	-	0	0.1	0.2	0.7
11 Pasuritë e patundshme	9.1	13	13.7	14.7	14.8
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	0.5	0	0.5	0.5	0.5
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	4.2	8	4.2	4.5	4.5
14 Të tjera	7.3	4	10.1	12.2	12.2
Totali	100	100	100.0	100.0	100.0

IV. TREGJET DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT


IV.1 ECURIA E LIKUIDITETIT

Tregu ndërbankar ka ruajtur të njëjtin intensitet të aktivitetit të tij për nga vëllimi i transaksioneve. Niveli mesatar i transaksioneve në muajin korrik shënoi 0.45 miliardë lekë, duke qenë pranë atij të qershorit. Ndërsa në muajin qershor janë regjistruar kryesisht vetëm transaksione njëditore, në muajin korrik është vënë re shtim i numrit të transaksioneve njëjavore.

Niveli i likuiditetit të sistemit bankar ka shënuar rritje gjatë muajit korrik. Vlera mesatare e tij shënoi shifrën 8.9 miliardë lekë krahasuar me 5.2 miliardë në muajin qershor. Kjo rritje e likuiditetit erdhi pjesërisht si rezultat i uljes së financimit të deficitit buxhetor nga sistemi bankar dhe pjesërisht si rezultat i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Në fund të muajit korrik treguesi i likuiditetit ra në vlerën 6.8 miliardë lekë, rreth 1.2 miliardë lekë më pak sesa në fillim të muajit.

Për tërheqjen e likuiditetit të tepërt janë përdorur instrumentet e repove njëjavore dhe njëmujore, të ofruar në të dyja llojet e ankandeve, me interes fiks dhe me interes të papërcaktuar.

Grafik 13. Niveli i likuiditetit të sistemit bankar (në milionë lekë).



Niveli mesatar i depozitës njëditore shënon shifrën 0.5 miliardë lekë, krahasuar me 1.1 miliardë në muajin qershor. Megjithë kushtet e tepricës së likuiditetit, ka patur raste të shpeshta të lëvrimit të kredisë njëditore, kryesisht për qëllime operationale.

Në tregun primar, shumat e emetuara nga qeveria në bono thesari janë përballuar nga sistemi bankar dhe nga individët. Kërkesa e bankave për bono thesari të qeverisë ka qenë më e lartë sesa shumat e emetuara dhe e përqendruar në letrat me vlerë për afate gjashtëmujore e dymbëdhjetmujore, duke rezultuar në rritjen e konkurrencës për to. Megjithë interesimin e bankave tregtare për të investuar në këtë treg, portofoli i tyre ka pësuar rënie, si pasojë e maturimeve të bonove të thesarit në një masë më të madhe se

emetimet e reja. Rrjedhimisht, është ulur financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar dhe është rritur niveli i likuiditetit të bankave.

IV.2 ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Reagimi ndaj politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë është vënë re në tregun e depozitave në lekë, në tregun primar dhe në tregun ndërbankar. Ndërkohë, në tregun e kredive në lekë ka patur rritje të interesave.


Gjatë muajit qershor, interesat e depozitave në lekë janë ulur pothuajse për të gjitha afatet, në ndjekje të reduktimit prej 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit në *muajin maj*. Ulja e mëtejshme, prej 0.25 pikë përqindjeje e normës së interesit të repos në fund të *muajit qershor*, është reflektuar pjesërisht në këto të dhëna të fundmuajit. Nga të dhënat operative, rezulton se reagimi i bankave ndaj ndryshimit të qershorit ka vazhduar i plotë në muajin korrik, ndërkohë që ulja tjetër (-0.25 pikë përqindjeje) e normës së repos në fund të *muajit korrik* po reflektohet gjatë muajit gusht.

Tabelë 10. Ndryshimi i interesave të depozitave në lekë (në pikë përqindjeje).

	maj-qershor '04	qershor '03-qershor '04
Llogari rrjedhëse	-0.14	-0.41
Depozita 1-mujore	-0.26	-1.65
Depozita 3-mujore	-0.17	-1.92
Depozita 6-mujore	-0.20	-1.69
Depozita 12-mujore	-0.23	-1.73
Interesi mesatar i ponderuar	-0.20	-1.83


Reagimi i tregut primar ndaj sinjaleve të Bankës së Shqipërisë ka qenë më i vogël se sa reagimi i tyre në tregun e depozitave pasi, në kushtet e një politike lehtësuese, bankat preferojnë të ulin më ngadalë dhe më pak interesat e investimeve, ndërkohë që shpejtojnë të ulin interesat e pranimit të depozitave. *Yield*-i i bonove të thesarit gjatë periudhës korrik - 8 gusht është ulur me 0.1 pikë përqindjeje për maturitetet gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore.

Grafik 14. Yield-i i bonove të thesarit në tregun primar.



Me gjithë tendencën rënëse të interesave, në treg ndërbankar ka patur dhe luhajtje të tyre në transaksionet e huamarrjes njëditore. Mospjesëmarrja e Bankës së Kursimeve gjatë muajit korrik, ka ulur konkurrencën në këtë treg duke bërë që disa pjesëmarrës të ofrojnë interesa më të lartë nga niveli i interesave të tregut.

Grafik 15. Ecuria e normave të interesit në treg ndërbankar.



Sidoqoftë, interesat e tregut ndërbankar kanë qëndruar pranë interesave të depozitave njëditore dhe interesave të repos njëjavore. Në javën e parë të muajit gusht interesat për transaksionet njëditore arritën në 3.25 për qind nga 3.80 për qind që ishin para ndryshimit të normës bazë të interesit në fund të korrikut.

Gjatë muajit qershor, niveli mesatar i ponderuar i interesit të kredive të dhëna në lekë arriti në 14.27 për qind nga 12.72 për qind që ishte një muaj më parë. Vërejmë se nuk kanë munguar rastet e uljes së interesave të kredive në lekë nga bankat, ndërkohë që rritja e nomës së ponderuar për to është pasojë e strukturës së tregut të kredisë².

Gjatë muajit qershor, interesat e depozitave në dollarë u ulën thuajse në të gjitha afatet, me përjashtim të atyre dymbëdhjetëmujore. Ulja mujore e

² Në tregun e kredisë janë aktive një numër i vogël bankash dhe politikat e ndjekura nga bankat dominuese bëhen përcaktuese për ecurinë e normave të interesit të sistemit.


interesave të depozitave me afat në dollarë ishte 0.04 pikë përqindjeje, ndërsa në krahasim me një vit më parë këta interesa janë ulur me 0.23 pikë përqindjeje. Në të kundërt, interesat e depozitave me afat në euro janë rritur me 0.17 pikë përqindjeje duke arritur në një nivel prej 1.56 për qind.

Rritje kanë pësuar edhe normat e kredive në dollarë dhe në euro. Në dollarë, kjo normë arriti në nivelin 7.81 për qind duke u rritur me 0.6 për qind krahasuar me një muaj më parë. Ndërsa në euro, norma e interesit për kreditë u rrit me 0.35 pikë përqindjeje duke arritur në nivelin 8.62 për qind.

IV.3 KURSI I KËMBIMIT

Tendenca e mëparshme e mbiçmimit të lekut ka vijuar edhe gjatë ditëve të para të muajit korrik. Kështu në 8 korrik kursi i këmbimit të lekut kundrejt dollarit, arriti në 100.11 lekë/dollarë ndërsa kursi i këmbimit në raport me euron, në ditët e para të korrikut, arriti në 122.73 lekë/euro, duke shënuar ndër nivelet më të ulëta që nga muaji mars i vitit 2003.

Grafik 16. Ecuria e kursit lekë/euro dhe lekë/usd.



Ndër faktorët që kanë ndikuar në mbiçmimin e lekut përmendim: rritjen e prurjeve të valutës në sezonin turistik; rritjen e prodhimeve bujqësore të vendit, të cilat kanë ulur kërkesën për valutë, preferencën e depozituesve për lekun, në kushtet kur interesat e depozitave në valutë kanë qenë të ulëta etj..

Për të frenuar mbiçmimin e mëtejshëm të lekut, duke ditur se faktorët e mësipërm do të vazhdonin të ishin të pranishëm edhe gjatë muajve korrik e gusht, Banka e Shqipërisë ndërhyri në treg duke blerë valutë. Këto blerje kanë rritur kërkesën e valutës në treg dhe kanë ndikuar në stabilizimin e kursit të këmbimit për të dyja valutat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

NR. 61, DATË 18. 08. 2004

PËR MIRATIMIN E

**“TRANSFERIMIT TË PRONËSISË SË 100 PËR QIND TË
AKSIONEVE TË KAPITALIT AKSIONER TË BANKËS SË KURSIMEVE
sh.a. NGA RAIFFEISEN ZENTRALBANK
OSTERREICH AG TEK RAIFFEISEN INTERNATIONAL BANK-
HOLDING AG”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të rregullores “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin për transferimin e pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës së Kursimeve sh.a. nga Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG tek Raiffeisen International Bank-Holding AG.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli MEMISHA

KRYETARI
Shkëlqim CANI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 62, datë 18.08. 2004

**PËR MIRATIMIN E
"Rregullave të funksionimit të sistemit IDBS"**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun, në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 43 pika f,

V E N D O S I:

1. Të miratojë "Rregullat e funksionimit të sistemit IDBS", sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat e Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI
Shkëlqim CANI**

RREGULLA TË FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT
INTERNET/INTRANET - IDBS

1.	Të Përgjithshme.....	24
1.1.	Baza ligjore.....	24
1.2.	Objekti dhe qëllimi.....	24
1.3.	Përkufizime.....	24
2.	Njësitë, detyrat dhe funksionet e tyre në IDBS.....	25
2.1.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës.....	25
2.2.	Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.....	25
2.3.	Të gjitha njësitë e Bankës së Shqipërisë.....	26
3.	Operimi në sistemin IDBS.....	26
3.1.	Të drejtat e njërive për përditësimin e IDBS.....	26
3.2.	Ndryshimet në strukturën e IDBS.....	27
3.3.	Plani i përditësimit (“To do list”).....	27
3.4.	Përditësimi dhe kontrolli i dyfishtë.....	28
3.5.	Publikimi nëpërmjet mjeteve automatike.....	28
3.6.	Administrimi i të abonuarve.....	28
3.7.	Opinione dhe kërkesa të publikut.....	29
3.8.	Skedimi i dokumentacionit.....	29
3.9.	Përkthimi dhe redaktimi i materialeve.....	30
4.	Administrimi dhe testimi i IDBS.....	30
4.1.	Përdoruesit.....	30
4.2.	Arkivimi.....	30
4.3.	Helpdesk.....	31
4.4.	Testimi i ndryshimeve.....	31
5.	Rastet e emergjencës.....	31
5.1.	Rastet e emergjencave në IDBS.....	31
5.2.	Rastet e emergjencave në Komunikim.....	32
6.	Dispozita të fundit.....	32
6.1.	Manualet e vendeve të punës.....	32
6.2.	Hyrja në fuqi.....	32

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 BAZA LIGJORE

Ky dokument është hartuar në përputhje dhe në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

1.2. OBJEKTI DHE QËLLIMI

Kjo rregullore përcakton veprimtarinë, përgjegjësitë, procedurat dhe ndërveprimin midis njësive të Bankës së Shqipërisë në administrimin dhe në operimin e sistemit Internet/Intranet të Bankës së Shqipërisë (IDBS).

SUBJEKTET

ZBATIMI I KËTYRE RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE, PJESË E KËSAJ RREGULLORE, ËSHTË I DETYRUESHËM PËR TË GJITHA STRUKTURAT E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Qëllimi i rregullores është përdorimi me efikasitet dhe me përfitueshmëri maksimale i sistemit IDBS në komunikimin transparent, me shpejtësi dhe me cilësi të Bankës së Shqipërisë me publikun vendas dhe të huaj.

1.3. PËRKUFIZIME

Për efekt të këtij dokumenti, termat e mëposhtëm do të kuptojnë:

Internet - (pjesa internet e sistemit IDBS), që konsiston në pajisje dhe programe, të cilat mundësojnë publikimin, administrimin dhe leximin e informacioneve të publikuara në faqen publike të internetit të Bankës.

Intranet - (pjesë intranet e sistemit IDBS) që konsiston në pajisje dhe programe, të cilat mundësojnë publikimin, administrimin dhe leximin e informacioneve të brendshme dhe që realizon shpërndarjen e këtij informacioni brenda bankës me të njëjtat teknika si ajo e përshtatur në publikimet internet.

IDBS (Internet/Internet database system) është një sistem informacioni që konsiston në pajisje dhe programe të cilat mundësojnë publikimin, kontrollin dhe administrimin në mënyrë të sigurtë të informacionit publik (internet) dhe të brendshëm (intranet) të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet standardeve dhe teknikave të sotme të publikimit në internet.

Profil i përdoruesit - është bashkësia e të drejtave dhe e kufizimeve që një përdorues funksional ka lidhur me një sistem.

Help Desk - është shërbimi i asistencës së përdoruesve të ndryshëm të sistemit IDBS dhe që ka për qëllim ndjekjen dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo funksionale, që lidhen me mosfunksionimin e rregullt apo me përdorimin e gabuar të sistemit. Shërben si pikë e unifikuar kontakti me

firmën ofruese përsa i përket mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit, si dhe në bashkëpunim me njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë ndjek procesin e rishikimit të manualeve të operimit të IDBS.

2. NJËSITË, DETYRAT DHE FUNKSIONET E TYRE NË IDBS

2.1. DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE STATISTIKËS

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës kryen detyrat e mëposhtme:

Ndërmerr në mënyrë të vazhdueshme , në bashkëpunim me Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun, iniciativa për përmirësimin e paraqitjes, e funksionaliteteve të shfletimit si dhe të organizimit të informacionit në IDBS.

Garanton sigurinë e të dhënave.

Organizon dhe ndjek shërbimin e *Help Desk* për përdoruesit e sistemit. Identifikon dhe zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me funksionimin e përgjithshëm të IDBS.

Administron ndryshimet në IDBS.

Ndjek zbatimin e kontratave që Banka e Shqipërisë ka nënshkruar me kompanitë e ndryshme në fushën e funksionit të IDBS si dhe të sistemeve të tjera të lidhura me të.

Përgatit dhe përditëson kuadrin rregullativ të IDBS si dhe organizon dhe drejton trainimin e përdoruesve të sistemit.

2.2. DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun kryen detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

Analizon në mënyrë të përbashkët me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit mundësinë dhe nevojën e ndryshimeve në strukturë, të propozuara nga njësitë e ndryshme organizative të Bankës së Shqipërisë, në pjesën internet të IDBS.

Përcakton, në mënyrë të përbashkët me njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë, kalendarin e publikimit (në shqip dhe anglisht), vjetërimin dhe rifreskimin e materialeve në internet.

Miraton publikimin e materialeve në pjesën internet të IDBS.

Kryen ndjekjen në mënyrë ditore të procesit të abonimeve “on-line” si dhe të problematikave të ndryshme të abonuesve.

Ndjek e analizon sjelljen, numrin dhe opinionet e lexuesve të internet dhe përpiqet për një përafrim më të madh të IDBS me nevojat dhe me kërkesat e tyre.

Përpiqet të promovojë pjesën internet të IDBS, në një numër sa më të madh lexuesish.

2.3. TË GJITHA NJËSITË E BANKËS SË SHQIPËRISË

Të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë, janë përdoruese dhe përditësuese të sistemit IDBS. Ato mundet, në çdo kohë, të paraqesin mendime lidhur me mënyrën e përmiresmit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të IDBS si dhe të përmbajtjes së saj. Në veprimtarinë ditore të IDBS njësitë kanë për detyrë:

Të përditësojnë/të shtojnë në pjesën internet, informacionin për të cilin janë direkt përgjegjëse, në përputhje me të drejtat dhe me detyrimet e përcaktuara nga **Zëvendësguvernatori i Parë**.

Të respektojnë të gjitha afatet dhe kushtet e publikimit, të përcaktuara në planin e përditësimeve, duke ndjekur dhe zbatimin e tij në pjesën direkt në përgjegjësi.

Të ndërmarrin hapat e nevojshëm lidhur me redaktimin e materialeve për publikim.

Të njoftojnë *Help Desk*, në çdo rast konstatimi të çfardo lloj anomalie në faqen e internetit.

Të plotësojnë dhe të zhvillojnë, në mënyrë të pavarur, pjesën intranet të vetë njësisë, duke iu përmbajtur pamjes dhe mjeteve të përgjithshme të IDBS si dhe udhëzimeve të herë pas hershme, që mund të dalin për këtë qëllim.

3. OPERIMI NË SISTEMIN IDBS

3.1 TË DREJTAT E NJËSIVE PËR PËRDITËSIMIN E IDBS

Procesi i përditësimit të informacionit në IDBS do të realizohet në mënyrë të decentralizuar nga të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë. Për këtë, veç pjesës intranet të cilën çdo njësi e administron në mënyrë të pavarur, pjesa internet e IDBS do të ndahet sipas njësive dhe në përputhje me detyrat dhe me funksionet e vetë njësisë.

Ndarja e përgjegjësisë dhe e të drejtave të njësive organizative të Bankës në pjesë të veçanta të strukturës së pjesës internet, bëhet me miratimin e Zëvendësgubernatorit të Parë dhe në përputhje me detyrat dhe me funksionet e çdo njësie. Në çdo rast, të drejtat e njësive do të kufizohen vetëm në hedhjen paraprake të informacionit, ndërsa autorizimi përfundimtar i publikimeve do të kryhet nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.

Njësitë zhvillojnë dhe mirëmbajnë në mënyrë të pavarur informacionet që do të publikohen në intranetin e njësisë së tyre.

3.2. NDRYSHIMET NË STRUKTURËN E IDBS

NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË VAZHUESHËM TË IDBS, STRUKTURA E SAJ SËBASHKU ME PËRMBAJTJEN, MENDOHEM TË JENË GJITHNJË NË ZHVILLIM DHE NË PËRPUTHJE ME TENDENCAT E TREGUT NGA NJËRA ANË DHE NEVOJAVE TË LEXUESVE NGA ANA TJETËR. PËR KËTË IDBS OFRON MJETE TË MJAFTUESHME PËR TË ZHVILLUAR NË ÇDO KOHË E NË MËNYRË TË THJESHTË NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË PREZANTIMIT TË MATERIALEVE. KY PROCES DUHET TË ADMINISTRUOHET ME KUJDES PËR TË RUAJTUR KONSISTENCËN NË SHFLETIM SI TË PJESËS INTERNET ASHTU DHE INTRANET, SI DHE PËR TË KRIJUAR VIJUESHMËRI TEK LEXUESI.

Për këtë, realizimi i ndryshimeve duhet të kryhet në mënyrën e mëposhtme:

Të gjitha njësitë e Bankës së Shqipërisë, të cilat do të kërkojnë ndryshimin, pasurimin apo përmirësimin në pjesën IDBS, duhet ta realizojnë atë në përputhje me udhëzimet e dala për këtë çështje. Propozimet e ndryshimeve në pjesën internet të IDBS, do të kryhen nga njësia përgjegjëse për atë pjesë të strukturës, vetëm pas miratimit paraprak të Zëvendësgubernatorit të Parë. Propozimi i njësive, në çdo rast, paraqitet pranë Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun, i cili në konsultim të përbashkët me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Statistikës dërgon për miratim propozimin sëbashku me komentet përkatëse.

3.3 PLANI I PËRDITËSIMIT ("TO DO LIST")

Realizimi i përditësimeve në IDBS duhet të jete një proces i vazhdueshëm dhe i administruar me kujdes. Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun në bashkëpunim me njësitë përkatëse, duhet të hartojë dhe të mirëmbajë "planin e përditësimeve". Plani duhet të rifreskohet pas çdo ndryshimi në strukturën e IDBS, ndërsa kujdes i veçantë duhet të tregohet në djekjen e realizimit të tij.

Për këtë, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun dukë përdorur lehtësitë e kontrollit automatik të përditësimit, duhet të plotësojë dhe rifreskojë në sistemin IDBS planin e përditësimit duke ndjekur, gjithashtu, mirëfunksionimin e sistemit të tij të sinjalizimit. Ky sistem sinjalizimi, aty ku

është e mundur, duhet të konfigurohet për të dërguar pranë njësive përgjegjëse njoftime automatike (nëpërmjet sistemit të *email-it*), për çdo vonesë të hasur në përditësim.

Megjithatë, në mënyrë të pavarur Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun merr masa për njoftimin e drejtuesve të njësive për çdo vonesë.

3.4. PËRDITËSIMI DHE KONTROLLI I DYFISHTË

Për të siguruar kontroll mbi procesin e decentralizuar të përditësimit, sistemi i të drejtave mbi pjesën internet të IDBS duhet të kontrollohet me kujdes. Në çdo rast, gjatë dhënies së të drejtave të përdoruesve mbi pjesë të veçanta të strukturës së IDBS, duhet detyrimisht të kihen parasysh përgjegjësitë dhe detyrat e vetë njësisë ku punonjësi bën pjesë.

Për të siguruar besueshmëri të informacionit e njëtrajtshmëri të paraqitjes së tij, çdo përditësim duhet të tentohet të kryhet nëpërmjet kontrollit të dyfishtë. Atje ku është e mundur, përditësimi në pjesën internet të IDBS duhet të kryhet vetëm pas autorizimit të dytë të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun.

Në rast gabimesh apo mosrespektimi kushtesh për publikim, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun duhet të refuzojë publikimin e materialit si dhe të njoftojë njësinë përgjegjëse për parregullsitë e hasura.

3.5. PUBLIKIMI NËPËRMJET MJETEVE AUTOMATIKE

Sistemi IDBS në ndihmë të procesit të përditësimit, të kontrollit e të monitorimit të përdorimit është i pajisur me një sërë mjetesh automatike përditësimië. Çdonjëri prej tyre, në varësi nga qëllimi dhe specifika, duhet të administrohet vetëm nga njësitë të cilat justifikojnë përdorimin e tyre.

Mjetet automatike, si rregull, duhet të tentohet të përdoren vetëm nga një njësi organizative dhe nga një numër i kufizuar përdoruesish. Të drejtat mbi to përcaktohen nga Zëvendësguvernatori i Parë, sëbashku me përgjegjësitë e njësive për pjesë të ndryshme të IDBS.

3.6. ADMINISTRIMI I TË ABONUARVE

Një ndër mjetet e administrimit të IDBS është njoftimi automatik i përdoruesve të abonuar (të brendshëm apo të jashtëm) sipas fushave dhe dëshirave të tyre. Përgjithësisht, procesi i abonimit kryhet nga vetë përdoruesit e faqes internet, por në raste të veçanta (dëshirën e lexuesit)

abonimi mund të kryhet edhe nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun. Rregjistrimet e realizuara nga ky Departament, në **çdo rast**, duhet të realizohen **vetëm me kërkesën** e lexuesit.

Në administrimin e këtij mjeti, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun ndjek funksionimin e rregullt të mjetit dhe për çdo parregullsi të hasur apo të raportuar, duhet të njoftojë menjëherë pranë *Help Desk-ut*.

Të abonuarit herë pas here mund të kontaktohen me qëllim vjeljen e mendimit të tyre për cilësinë e shërbimit si dhe mënyrën e përmirësimit të elementeve të veçanta në faqe.

Si rregull, çdo muaj, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun kryen një analizë të shkurtër rreth ecurisë së abonimit, dhe mundohet që prej saj të ndër marrë iniciativa për përmirësime.

3.7. OPINIONE DHE KËRKESA TË PUBLIKUT

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun ndjek në mënyrë të vazhdueshme kërkesat/opinionet e publikut të komunikuara nëpërmjet IDBS. Ai kryen përpjekjet maksimale për trajtimin dhe përgjigjen në kohë të tyre. Në raste të veçanta, kur përgjigja është e pamundur të realizohet nga ky departament, kërkesat dërgohen pranë njësive direkt përgjegjëse.

Në mënyrë periodike, opinionet dhe kërkesat e publikut analizohen me qëllim: përmirësimin e mëtejshëm të pjesës internet të IDBS.

3.8. SKADIMI I DOKUMENTACIONIT

Për qëllim të ruajtjes së integritetit të informacionit e sigurimit të vazhdueshëm të përditësimit të tij, IDBS është në gjendje të administrojë afate maksimale "skadimi" të materialeve. Pas kësaj date, IDBS në mënyrë automatike "fsheh" dokumentet e *skaduar* duke mos lejuar leximin e tyre.

Përcaktimi i datës së *skadimit* të dokumentit bëhet nga vetë njësia përgjegjëse për përgatitjen dhe përditësimin e materialeve. Përcaktimi i këtyre datave shërben si kriter kontrolli për vjetërsinë dhe për vlefshmerinë e informacionit. Për këtë, publikuesit rekomandohen të përcaktojnë sa më shumë data të tilla.

Në vijim, të gjitha njësitë përgjegjëse për informacionet, duhet që në mënyrë të rregullt të kontrollojnë afrimin e datave të *skadencës* së materialeve, duke garantuar përditësimin e tyre në kohë. Gjithashtu, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, në mënyrë të përgjithshme dhe të pavarur,

kontrollon për *skadime* të mundshme dhe informon njësinë përgjegjëse për çdo gjetje.

3.9. PËRKTHIMI DHE REDAKTIMI I MATERIALEVE

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun në bashkëpunim me njësinë përgatitëse, vendos për materialet që duhet të jenë në dy gjuhë, duke përcaktuar personin që do ta përkthejë materialin dhe kohën kur materiali i përkthyer do të paraqitet për publikim. Redaktimet dhe përkthimet e materialeve realizohen sipas kësaj rregulloreje dhe rregullave të përcaktuar në aktet e tjera administrative të Bankës së Shqipërisë.

4. ADMINISTRIMI DHE TESTIMI I IDBS

4.1. PËRDORUESIT.

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, në bazë të kërkesave të njësive, miraton përdoruesit dhe të drejtat e tyre në pjesën internet të IDBS. Ky përcaktim kryhet mbi bazën e propozimeve të njësive të ndryshme organizative si dhe në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre të përcaktuara nga **Zëvendësguvernatori i Parë**. Për të ndihmuar procesin e krijimit dhe të miratimit të përdoruesve në IDBS, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit krijon dhe mirëmban një "formular tip", i cili është i detyrueshëm për t'u përdorur nga të gjitha njësitë.

Pas marrjes së miratimit të mësipërm, *Help Desk* realizon krijimin e përdoruesve në pjesën intranet të IDBS. Krijimi i përdoruesve në pjesën intranet të njësisë kryhet vetëm kundrejt kërkesës me shkrim të drejtuesit të njësisë.

Administrimi i përdoruesve si dhe i fjalëkalimeve kryhet në përputhje me procedurat e sigurisë të hartuara për këtë qëllim.

Drejtuesit e njësive organizative, duhet që pas përfundimit të kontratës së punësimit, të lëvizjes në njësi të tjera apo gjatë largimit të zgjatur të përdoruesve, të kërkojnë pranë *Help Desk* heqjen e menjëhershme të të drejtave në IDBS.

4.3. ARKIVIMI

Arkivimi i të dhënave në IDBS, si rregull, duhet të kryhet çdo javë nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës. Arkivimi i plotë,

duke përfshirë dhe aplikimet e programeve të ndryshme të IDBS realizohet në mënyrë të rregullt mujore.

4.3. HELPDESK

Me marrjen e një kërkesë nga përdoruesit e IDBS, *Help Desk* e regjistron kërkesën në një bazë të dhënash, duke plotësuar gjithashtu, informacione të tjera shtesë që lidhen me kërkuuesin e informacionit. Për realizimin e këtij inventari mund të përdoren dhe programe të posaçme.

Kur një kërkesë nuk mund të zgjidhet brenda njohurive të punonjësve të HelpDesk, ajo i adresohet pikës së asistencës së firmës “Ark-IT”. Në të gjitha rastet, HelpDesk ndjek shpejtësinë e përgjigjes së çështjeve të ngritura dhe në rast vonesash të pajustificuara, bën njoftimin tek drejtuesi përkatës.

4.4. TESTIMI I NDRYSHIMEVE

Testimi dhe zbatimi i ndryshimeve realizohen në përputhje me “Procedurat për administrimin e ndryshimeve”. Realizimi i ndryshimeve, testimi dhe zbatimi i tyre në IDBS duhet të kryhen pas miratimit të përbashkët të drejtuesve të Departamentit Kontabilitetit dhe Pagesave dhe të Departamentit Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës.

Aplikimi i versioneve të reja dhe i ndryshimeve në IDBS, miratohet vetëm pas analizës së “fizibilitetit” të këtyre ndryshimeve. Si rregull, çdo ndryshim i rëndësishëm në IDBS duhet të kryhet pas konsultimit paraprak me njësitë organizative të Bankës.

5. RASTET E EMERGJENCËS

5.1. RASTET E EMERGJENCAVE NË IDBS

Administrimi i situatave të emergjencës bëhet në mënyrë të përbashkët nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, në mbështetje me procedurat që mund të përcaktohen për ngjarjet e paparashikuara.

Bashkëveprimi i njësive të përfshira në procesin e zgjidhjes së gjendjes së emergjencës duhet të ndjekë, ndër të tjera, hapat e mëposhtëm:

- Njoftimin dhe shpalljen e gjendjes së emergjencës.
- Kryerjen e veprimeve që lidhen me zgjidhjen e gjendjes.
- Tërheqjen e gjendjes së emergjencës .

Në rastet e emergjencave të shkaktuara nga dëmtimi i IDBS, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës ndjek me përparësi procedurat përkatëse për rivënien në operim të sistemit, duke synuar zgjidhjen sa më të shpejtë të situatës. Hapat për riparimin e dëmtimeve dhe për vënien në funksionim të sistemit primar, duhet të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit me "Akr-IT" dhe në përputhje me procedurat e mirëmbajtjes.

Pas tërheqjes së gjendjes së emergjencës, operatorët e sistemit, në mënyrë të veçantë Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, duhet të bëjnë një monitorim dhe një kontroll të hollësishëm mbi gjendjen e sistemit.

Në shfaqjen e forcave madhore, të cilat kërkojnë ndalimin e funksionimit të IDBS, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës ndërmerr hapat e nevojshëm për ndalimin e menjëhershëm të funksionimit të sistemit, në mënyrë që të mbrohen pajisjet, të dhënat si dhe komponentë të tjerë mbështetës të tij.

Me përfundimin e ngjarjeve që përbënin forca madhore, të cilat shkaktuan emergjencën, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës kujdeset për rifillimin e operimit të IDBS, duke monitoruar dhe duke kontrolluar me kujdes gjendjen e sistemit.

5.2. RASTET E EMERGJENCAVE NË KOMUNIKIM

Në rastet e mosfunksionimit të rregullt të komunikimit internet apo të pjesëve të brendshme të komunikimit IDBS, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës duhet të marrë masa të menjëhershme për shmangien e tyre. Në rastet e ndërprerjeve të gjata, departamenti duhet të kryejë informimin e përdoruesve kryesorë rreth vështirësive.

6. DISPOZITA TË FUNDIT

6.1. MANUALET E VENDEVE TË PUNËS .

Organizimi i punës brenda njësive të Bankës së Shqipërisë, për realizimin e detyrave të mësipërme, përcaktohet në manualët mbi procedurat e punës për çdo njësi si dhe në përshkrimet e vendeve të punës. Këto manuale hartohen në përputhje me manualët e përdorimit të IDBS dhe me rregulloret përkatëse të çdo njësie.

6.2. HYRJA NË FUQI.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës
Shkëlqim Cani**

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SËIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. “Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.

6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.

2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004. Për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës”.

2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004. “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr. 57, date 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004. Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.

4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004. Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Mars 2004

1. Vendim nr. 26, datë 14. 04. 2004. Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve.

2. Vendim nr. 27 datë 14. 04. 2004. “Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004

1. Vendim nr. 28, datë 28 04. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.

2. Vendim nr. 29, datë 28 04. 2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore”.

3. Vendim nr. 30, datë 28. 04. 2004. Për dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.

4. Vendim nr. 31, datë .28 04. 2004. Për “Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004

1. Vendim nr. 35, datë 12 05. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004

1. Vendim nr. 36, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e Raportit “Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004”.

2. Vendim nr. 37, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.

3. Vendim nr. 38, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores “Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”.

4. Vendim nr. 39, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004

1. Vendim nr. 46, datë 09. 06. 2004. Për “Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 11, Korrik 2004

1. Vendim nr, 47, datë 18.6.2004. Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2004”.

2. Vendim nr. 48, datë 18.6.2004. “Për disa ndryshime në rregulloren për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 12, Korrik 2004

1. Vendim nr, 50, datë 23. 06. 2004. “Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

2. Vendim nr. 51, datë 23. 06. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 13, Korrik 2004

1. Vendim nr, 52, datë 14.07. 2004. Për “Administrimin e rrezikut të kredisë”
2. Vendim nr. 53, datë 14.07. 2004. Për “Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, në vitin 2005”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 14, Korrik 2004

1. Vendim nr. 56, datë 28.07.2004. Për “Miratimin e raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr. 57, datë 28.07.2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.
3. Vendim nr. 58, datë 28.07.2004. Për “Miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri””.
4. Vendim nr. 59, datë 28.07.2004. Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit aktual dhe emërimin e Drejtorit të ri të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.